



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK**

PROÇESVERBAL

Nr.18, datë 30.09.2021

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Shtator, që zhvillohet me mjete të komunikimit elektronik (aplikacioni SKYPE).

Orari i fillimit të mbledhjes : 12 : 07

Data e mbajtjes së mbledhjes : 30.09.2021

Mbajtja e mbledhjes : Online aplikacioni SKYPE

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Rradhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës : Zëvendëskryetare zj.Emiriana Sako (Kryetare në detyrë) dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi : Përshëndetje të gjithëve ! Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare!

Uroj që të jeni të gjithë mirë Ju dhe familjet tuaja....

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin shtator të Këshillit Bashkiak Durrës me mjete të komunikimit elektronik .

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Zëvendëskryetarja e Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit Bashkisë.

Të gjithë materialet, siç jeni në dijeni, i keni marrë me postë elektronike.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë me prezencën. Jolanda Mustafaraj ...Prezent. Alfred Mullaraj ...ka votuar me email.....etj....deri në fund...Morena Boja.... Me email.....Atëherë Kryetar keni 31 këshilltarë që u dëgjuan online, ke dhe 13 këshilltarë që kanë votuar me email. (Në fakt pas shikimit të skype janë 32 këshilltarë, pasi këshilltari A.Beqiraj ka hyrë me vonesë online, gjithashtu gjatë mbledhjes me email votoi dhe N.Bodlli, A.Ramohitaj, pra janë 32 online dhe 15 email)

Ani Dyrmishi: Atëherë faleminderit. Meqë kuorumi është i pranishëm.

Pikat, që shtrohen sot për shqyrtim dhe miratim në rend dite janë 19, duke hequr pikën 3 ngelin 18. Vazhdojmë me prezantimin e rendit të ditës:

1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN SHTATOR 2021
2. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.76, DATË 28.06.2021 PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, DURRËS, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
3. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	Eshte hequr nga rendi ditës me kërkesë të Bashkisë Durrës
4. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 3.600.000 LEKË PËR OBJEKTIN “STUDIM PROJEKTIM PËR RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS “ADRIA” NGA ROTONDA E URËS SË DAJLANIT DERI TEK ROTONDA PRANË STACIONIT TË TRENIT”, KURSYER NGA PROÇEDURA E PROKURIMIT ME OBJEKT “RIKONSTRUKSION RRUGA “PAPA KLEMENTI I DYTË”
5. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MBI MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS, QË I PËRKET SHKOLLËS SË MESME “NAIM FRASHERI”, QË MBAN NR. 158, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET E TË NDËRTOHET NGA E PARA, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR E HARTUAR NGA STUDIO SHOQËRIA “ARKONSTUDIO” SHPK DHE Oponencës teknike të kryer nga instituti i ndërtimit dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin shkolla e mesme “NAIM FRASHERI”, QË MBAN NR.158 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS
6. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MBI MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS, QË I PËRKET SHKOLLËS FILLORE, CIKLI I ULËT (KOPSHT) BIZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM, QË MBAN NR. 12, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 295, DATË 02.05.2012, KA KALUAR NË PRONËSI TË ISH KOMUNËS ISHËM (SOT BASHKIA DURRËS), PËR SHKAK

	SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET E TË NDËRTOHET NGA E PARA, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR E HARTUAR NGA STUDIO SHOQËRIA “ARKONSTUDIO” SHPK DHE Oponencës teknike të kryer nga instituti i ndërtimit dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin shkolla fillore, cikli i ulët (kopsht), që mban nr.12 të listës së transferimit, që me VKM nr. 295, datë 02.05.2012, ka kaluar në pronësi të ish komunës ishëm (SOT BASHKIA DURRËS)
7. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MBI MIRATIMIN PËR PRISHJEN E Detyruar të godinës, që i përket shkollës 9-vjeçare dhe kopshti “EFTALI KOÇI”, që mban nr. 150, të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të bashkisë Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe është rekomanduar të prishet e të ndërtohet nga e para, kjo sipas aktekspertizës së thelluar e hartuar nga studio shoqëria “ARKONSTUDIO” SHPK dhe oponencës teknike të kryer nga instituti i ndërtimit dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin shkolla e mesme “EFTALI KOÇI”, që mban nr.150 të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të bashkisë Durrës
8. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MBI MIRATIMIN PËR PRISHJEN E Detyruar të godinës, që i përket shkollës së mesme “GJERGJ KASTRIOTI”, që mban nr. 157, të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të bashkisë Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe është rekomanduar të prishet e të ndërtohet nga e para, kjo sipas aktekspertizës së thelluar e hartuar nga studio shoqëria “ARKONSTUDIO” SHPK dhe oponencës teknike të kryer nga instituti i ndërtimit dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin shkolla e mesme “GJERGJ KASTRIOTI”, që mban nr.157 të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të bashkisë Durrës
9. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MBI MIRATIMIN PËR PRISHJEN E Detyruar të godinës, që i përket shkollës së mesme “BERNARDINA QERAXHI”, që mban nr. 164, të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të bashkisë Durrës, për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe

	ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET E TË NDËRTOHET NGA E PARA, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR E HARTUAR NGA STUDIO SHOQËRIA “ARKONSTUDIO” SHPK DHE Oponencës teknike të kryer nga Instituti i ndërtimit dhe miratimit për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin shkolla e mesme “Bernardina Qeraxhi”, që mban nr.164 të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, ka kaluar në pronësi të bashkisë durrës
10. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	MBI MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS, QË I PËRKET SHKOLLËS SË MESME “OLSI LASKU”, QË MBAN NR. 159, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS, PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE ËSHTË REKOMANDUAR TË PRISHET E TË NDËRTOHET NGA E PARA, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR E HARTUAR NGA STUDIO SHOQËRIA “ARKONSTUDIO” SHPK DHE Oponencës teknike të kryer nga Instituti i ndërtimit dhe miratimit për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të pronës me emërtimin shkolla e mesme “OLSI LASKU”, QË MBAN NR.159 TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KA KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË DURRËS
11. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-së NR. 64, DATË 07.07.2020 PËRSA I PËRKET LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E BANESAVE TË DËMTUAR SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
12. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR.55, DATË 26.06.2020, VKB NR. 64, DATË 07.07.2020, VKB NR.70, DATË 20.07.2020, VKB NR.115, DATË 30.09.2020, VKB NR. 11, DATË 04.02.2021, VKB NR. 15, DATË 22.02.2021 PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR
13. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR DETAJIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.514, DATË 18.09.2021 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E ZBATIMIT, MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT PËR REHABILITIMIN E INFRASTRUKTURËS SË RRJETIT TË KULLIMIT NË ZONËN E PORTO ROMANOS – KËNETË DHE SISTEMIMIN E RRJETIT TË UJËRAVE TË SHIUT NË ZONËN URBANE TË QYTETIT TË DURRËSIT DHE CAKTIMIN E

BASHKISË DURRËS SI NJËSI ZBATUESE

Pikat shtesë

<p>Pika 14. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË GJASHTË, TË 38 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL</p>
<p>Pika 15. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 4, 5, SI DHE NJËSISË ADMINISTRATIVE SUKTH, BASHKIA DURRËS, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>
<p>Pika 16. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË, TË MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E SHËMBJES SË BANESAVE TË TYRE (PALLATE), SHKAKTUAR NGA PRISHJA E DETYRUAR, SIPAS EKSPERTIZAVE TË THELLUARA, HARTUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË</p>
<p>Pika 17. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 2 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30, DATË 26.03.2021, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN KASTRATI, RRUGA “RAMADAN VELIU”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>
<p>Pika 18. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, LAGJA.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR.15&23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>
<p>Pika 19. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit</p>	<p>PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1 BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 3, 5, 7 RRUGA “BASHKIMI”, PALLATI NR. 1, RRUGA “DEMOKRACIA”, PALLATI NR.2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR.6, RRUGA “MILLENIUMI” DHE PALLATI NR.4, RRUGA “MINIERËS”, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019</p>

Ani Dyrmishi: Atëherë ky ishte rendi i ditës. Kush ka ndonjë koment para se ta hedhim në votim? Atëherë nuk ka koment. Kush është pro miratimit të rendit të ditës?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*). Ju lutem votoni kush është pro miratimit të rendit të ditës? Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni të gjithë kush nuk ka votuar ende. Eni të lutem ma verifikon pak votimin.

Eneida Marku (asistenca) : Janë ende duke votuar kolegët. Momentalisht kemi vetëm 1 apstenim në rendin e ditës dhe të tjerët, kolegët kanë votuar pro.

Ani Dyrmishi : Atëherë ka ndonjë pa votuar akoma?

Eneida Marku (asistenca) : Votimi përfundoi.

Ani Dyrmishi : Atëherë me 1 apstenim dhe votat e tjera pro miratohet rendi i ditës dhe 14 me email. Miratohet rendi i ditës

- **Vazhdojmë me shqyrtimin e pikës 1**, i jepet fjala për pikën 1, Komisionit të Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale me Kryetare znj. Klementina Meçi .
Znj. Meçi ? Eni është e lidhur zonja Meçi.

Eneida Marku (asistenca) : Po në linjë është. Mikrofoni e ka të hapur, por nuk dëgjohet.

Ani Dyrmishi : Po ritenton të lidhet. Atëherë znj. Meçi ke një problem teknik mund ta kaloj fjalën tek znj. Jolanda Mustafaraj.

Eneida Marku (asistenca) : Po Klea, të lutem pak më lartë zërin.

Klementina Meçi : Ok...

Ani Dyrmishi : Tani dëgjoresh Klea.

Klementina Meçi : Ok. Faleminderit z. Kryetar! Përshëndetje të gjithëve ! Komisioni i Barazisë Gjimore dhe Mirëqënies Sociale nëpërmjet komunikimeve elektronike, mori në shqyrtim pikën 1 të R.D dhe vendosi të miratoj përfitimin e ndihmës ekonomike nga të ardhurat dytësore për 91 familje. Miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi 6 % për 18 familje. Të hiqet nga skema 1 familje dhe të futen në skemë 3 familje të tjera për muajin shtator Ngasa më sipër komisioni vendosi me vota unanime për miratimin e projektvendimit dhe kalimin për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 1 të R.D ka? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 1 të R.D?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*).

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni të gjithë. Kush ka ngelur pa votuar të lutem të votojë Atëherë Eneida mund të ma konfirmosh votimin.

Eneida Marku (asistenca) : Deri tani të gjithë kolegët kanë votuar pro pikës 1. Janë ende duke votuar.

Ani Dyrmishi : Ju lutem votoni pak më shpejt. (...*qetësi, vazhdon të votohet në chat*).
Artioni është prezent. Atëherë besoj që është mbyllur Eneida apo po votojnë ende

Eneida Marku (asistenca) : Janë ende duke votuar.

Ani Dyrmishi : Ju lutem votoni kush nuk ka votuar.

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar dhe janë të gjithë pro pikës 1.

Ani Dyrmishi : Atëherë me të gjitha votat unanime pro miratohet dhe pika 1 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 2 të rendit të ditës**, i jepet fjala për projektvendimin e pikës 2, Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Po Kryetar, faleminderit ! Përshëndetje të gjithëve! Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike u mbledh dhe mori në shqyrtimin pikën 2 të rendit të ditës dhe me shumicë votash miraton propozimin e saj. Gjithashtu Komisioni ka dhe 2 kërkesa ndaj bashkisë me administratën më saktë.

Kërkesa e parë është që në rast se Komisioni i Ankesave i drejton Këshillit Bashkiak apo Komisionit tonë raste të tilla, kërkojmë nga anëtarët e këtij komisioni të jenë më të qartë e më explicit në vendimmarrjen e tyre.

Dhe e dyta është : Në mbledhjen e kaluar ka qënë një pikë në rend dite që "Ne" se kemi kaluar për një qytetar Enver Isufi. Është rasti po njësoj si ky i sotmi. Kërkojmë që në mbledhjen e ardhshme të futet dhe rasti i këtij personi z. Enver Isufi. Kaq. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike pasi u mbledh dje për shqyrtimin e pikës 2 të R.D, në lidhje me ndryshimin e VKB-së nr.76, propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 2 të R.D nga ana e këshilltarëve ka? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 2 të R.D?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*).

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni të gjithë.

Ju lutem votoni kush nuk ka votuar ende.

Eneida mund të ma konfirmosh pak votimin të lutem.

Eneida Marku (asistenca) : Deri më tani kemi vetëm 1 apstenim të pikës 2 dhe kolegët e tjerë janë pro.

Ani Dyrmishi : Është mbyllur procesi apo vazhdon?

Eneida Marku (asistenca) : Vazhdon.

Ani Dyrmishi : Ju lutem kush nuk ka votuar të votojë. Besoj Denisa ishte e fundit. Marjeta po, Artion...

Ju lutem votoni kush nuk ka votuar ende.

Atëherë është mbyll procesi i votimit me 1 apstenim të gjithë votat e tjera pro miratohet dhe pika 2 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 4 të rendit të ditës, pasi pika 3 është hequr nga rendi ditës,** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj : Faleminderit z. Kryetar ! Mirëdita të gjithëve!

Komisioni Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin e përgatitur nga drejtoritë përkatëse vendosi me të gjitha votat pro miratimin e fondit prej 3.600.000 lekë për objektin “Studim projektim për rikonstruksionin e rrugës “Adria” nga Rotonda e Urës së Dajlanit deri tek Rotonda pranë Stacionit të trenit”. Fond ky që do të merret nga kursimet e procedurës së prokurimit publik të objektit ”Rikonstruksion Rruga ”Papa Klementi i Dytë” . Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani. Znj. Velçani ? Eni është në linjë zonja Velçani?

Eneida Marku (asistenca) : Po në linjë është po nuk dëgjohet për momentin, mikrofonin e ka të hapur.

Ani Dyrmishi : Atëherë Velçani ? Po ritenton të lidhet dhe njëherë....Eva?

Eneida Marku (asistenca) : Nuk dëgjohet Etleva.

Ani Dyrmishi : T’i japim kohë dhe një minut.

Etleva Velçani : Përshëndetje më dëgjoni.

Ani Dyrmishi : Po Etleva mund të flasësh.

Etleva Velçani : Unë nuk dëgjoj prandaj. Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin është dakort për kalimin në votim të pikës 4. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit dhe Ju ! Atëherë komente përsa i përket pikës 4 kemi nga ana këshilltarëve ? Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 4 të R.D?*(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)*.
Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni.
Ju lutem kush ka ngelur pa votuar të votojë.
Eneida mund të ma konfirmosh procesin?

Eneida Marku (asistenca) : Deri më tani kolegët janë duke votuar. Nuk ka asnjë kundra asnjë apstenim , pro janë dhe janë ende duke votuar.

Ani Dyrmishi : Ju lutem kush nuk ka votuar të votojë....
Atëherë besoj që të gjithë kanë votuar. Asnjë votë kundra, asnjë apstenim të gjitha pro miratohet dhe pika 4 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e projektvednimit të pikës 5 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në lidhje me pikën 5 votoi në mënyrë unanime për ta kaluar në ditën e sotme. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj.Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi : Përshëndetje ! Edhe Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor votoi unanimitet që pika 5 të kalojë në votim në mbledhjen e sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 5 të R.D ka nga ana këshilltarëve ? Nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 5 të R.D?*(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)*.
Kundra ?..... Apstenim?.....*(vazhdon votimi)*.
Ju lutem votoni kush nuk ka votuar .
Atëherë besoj që kanë votuar të gjithë . Eneida mund të ma konfirmosh?

Eneida Marku (asistenca) : Të gjithë kolegët kanë votuar pro pikës 5.

Ani Dyrmishi Atëherë me gjithë votat pro miratohet dhe pika 5 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 6**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në lidhje me pikën 6, mbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket shkollës fillore, cikli i ulët (kopsht) Bizë, njësia administrative Ishëm, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 6 të rendit të ditës. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj.Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi : Edhe Komisioni ynë ra dakort që pika 6 të kaloj për miratim në mbledhjen e sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 6 të R.D kemi nga ana këshilltarëve? Nuk ka, atëherë kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 6 të R.D?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*).

Kundra ?..... Apstenim?.....(*vazhdon votimi*).

Ju lutem kush nuk ka votuar ende të votojë

Eni mund të ma konfirmosh ?

Eneida Marku (asistenca) : Janë ende duke votuar kolegët. Deri tani nuk ka asnjë kundra asnjë apstenim

Ani Dyrmishi : Ju lutem kush nuk ka votuar ende të votojë.

Atëherë Flutura ishte e fundit . Besoj kanë votuar të gjithë Eneida? Nuk ka më ?

Eneida Marku (asistenca) : Po po

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjithë votat pro, asnjë kundër asnjë apstenim miratohet pika 6 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 7**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores në lidhje me pikën 7, për miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket shkollës 9-vjeçare “Eftali Koçi”, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në ditën e sotme. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj.Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi : Edhe Komisioni ynë përsëri ra dakort për pikën 7 që të kaloj për miratim në mbledhjen e sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë komente përsa i përket pikës 7 të R.D nga ana këshilltarëve kemi ? Nuk kemi, atëherë kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 7 të R.D?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*).

Kundra ?..... Apstenim?.....(*vazhdon votimi*).

Ju lutem votoni kush nuk ka votuar, të votojë...

Eni ma konfirmon pak nëse procesi ka përfunduar apo vazhdon ?

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar të gjithë pro pikës 7. Nuk ka përfunduar ende procesi i votimit.

Ani Dyrmishi : Atëherë kush ka ngelur pa votuar, Pamela ishte e fundit besoj.

Atëherë me gjithë votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet dhe pika 7 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 8**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Në lidhje me pikën 8, për miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket shkollës së mesme “Gjergj Kastrioti”, Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj.Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi : Edhe Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor ra dakort që të kaloj për miratim pika 8. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Atëherë komente përsa i përket pikës 8 të R.D kemi nga ana këshilltarëve ? Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 8 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....(vazhdon votimi).

Ju lutem votoni kush nuk ka votuar.

Eneida ma konfirmon nëse ka ende këshilltarë në proces ?

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar të gjithë pro pikës 8. Ka përfunduar votimi.

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjithë votat pro dhe 15 me email miratohet dhe pika 8 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 9 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores në lidhje me pikën 9, për miratimin e prishjes detyruar të godinës, që i përket shkollës së mesme “Bernardina Qeraxhi”, sipas akt-ekspertizës së thelluar dhe opinionit teknik, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj.Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi : Edhe Komisioni ynë votoi unanimit që pika 9 të kaloj në votim mbledhjen e sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komente përsa i përket pikës 9 të R.D ka nga ana këshilltarëve ? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 9 të R.D?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*). Ju lutem votoni...

Kundra ?..... Apstenim?.....(*vazhdon votimi*).

Ju lutem kush ka ngelur pa votuar të votojë.

Eni të lutem ma konfirmon?

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar të gjithë pro pikës 9.

Ani Dyrmishi : Ka mbaruar procesi?

Eneida Marku (asistenca) : Po, mbaroi.

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjithë votat pro miratohet dhe pika 9 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 10**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores në lidhje me pikën 10, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor znj.Denisa Luarasi.

Denisa Luarasi : Edhe Komisioni ynë ra dakort që të kaloj sot në votim pika 10. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komente përsa i përket pikës 10 të R.D nga ana këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 10 të R.D?(*ndërkohë qetësi, po votohet në chat*). Ju lutem votoni...

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni..... (*vazhdon votimi*).

Eni të lutem ma konfirmo sapo të mbyllet procesi.

Atëherë Eni ma konfirmon?

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar të gjithë pro pikës 10 dhe janë 2 kolegë që po votojnë.

Votimi përfundoi.

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjithë votat pro miratohet dhe pika 10 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 11 të rendit të ditës**, i jepet fjala Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Po Kryetar, faleminderit ! Edhe për pikën 11, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në mënyrë unanime propozon për ta kaluar pikën 11 në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 11 të R.D, ka nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 11 të R.D?*(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)*.

Kundra ?..... Apstenim?.....Votoni të gjithë kush ka ngelur pa votuar ende.

Eneida mund të ma konfirmosh nëse kanë votuar të gjithë.

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar të gjithë pro pikës 11

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjitha votat pro miratohet dhe pika 11 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 12 të rendit të ditës**, i jepet fjala Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Po Kryetar, faleminderit ! Edhe për pikën 12, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 12 të rendit të ditës. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 12 të R.D, nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 12 të R.D?*(ndërkohë qetësi, po votohet në chat)*.

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni kush ka ngelur pa votuar.

Eneida mund të ma konfirmosh nëse kanë votuar të gjithë.

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar pro pikës 12.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Atëherë me gjithë votat pro asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 12 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 13 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj : Faleminderit! Edhe për pikën 13 Komisioni jonë vendosi pro miratimit të saj me të gjitha votat unanime. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani : Po edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës ra dakort me vota unanime për kalimin në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Përsa i përket pikës 13 të R.D, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 13 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....

Eneida të lutem ma konfirmon votimin.

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët janë ende duke votuar dhe deri më tani kemi të gjithë kolegët që kanë votuar pro, asnjë kundra dhe asnjë apstenim.

Ani Dyrmishi : Atëherë kush ka ngelur pa votuar të votojë.

Atëherë Nuriya ishte e fundit. Atëherë me gjithë votat pro asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet dhe pika 13 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 14 të rendit të ditës**, i jap fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar ! Edhe për pikën 14, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit z. Jani! Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Komisioni Rregullores në lidhje me pikën 14 mbi miratimin e listës së përfituesve me 38 subjekte përfituese nga program i rindërtimit propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Eni dëgjohem .

Eneida Marku (asistenca) : Po dëgjoresh. Dhe Komisioni i Rregullores është dakort për kalimin e kësaj pike për votim

Ani Dyrmishi : Ok se nuk dëgjoja unë prandaj.

Atëherë komente përsa i përket pikës 14 të R.D, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 14 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....

Kam problem me linjën.

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar të gjithë pro pikës 14, nuk ka asnjë kundra dhe asnjë apstenim. Aktualisht janë dhe duke votuar.

Ani Dyrmishi : Atëherë u mbyll dhe votimi për pikën 14 të R.D me gjitha votat pro, asnjë kundër dhe asnjë apstenim miratohet dhe pika 14 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 15 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar ! Edhe për pikën 15, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Eneida Marku (asistenca) : Alneida të lutem hap mikrofonin.

Alneida Rroshi : Kam problem me telefonin. Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në lidhje me pikën 15 propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 15 të R.D, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 15 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni kush nuk ka votuar.

Ju lutem kush nuk ka votuar të votojë.

Eneida mund të ma konfirmosh ka në proces votimi akoma këshilltarë?

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët janë ende duke votuar. Momentalisht të gjithë janë pro pikës 15.

Ani Dyrmishi : Atëherë kush nuk ka votuar ende të votojë.

Eneida Marku (asistenca) : Proçesi i votimit përfundoi.

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjithë votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet dhe pika 15 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 16 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar ! Edhe për pikën 16, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Gjithashtu dhe Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në lidhje me pikën 16, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 16 të R.D, nga ana e këshilltarëve ka? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 16 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni kush nuk ka votuar.

Eni ma konfirmon ka përfunduar proçesi?

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar të gjithë pro pikës 16.

Ani Dyrmishi : Atëherë miratohet dhe pika 16 e rendit të ditës me gjithë votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 17**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar ! Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj.Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Edhe Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në lidhje me pikën 17, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Komente përsa i përket pikës 17 të R.D, nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 17 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem kush nuk ka votuar të votojë.

Eni ka ende në proçes votimi këshilltarë ?

Eneida Marku (asistenca) : Kolegët kanë votuar pro pikës 17 dhe janë dhe disa kolegë, që po votojnë ende.

Ani Dyrmishi : Ok, Ju lutem votoni.

Eneida Marku (asistenca) : Përfundoi votimi.

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjithë votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 17 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 18 të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Po Kryetar ! Dhe për pikën 18 të rendit të ditës, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Alneida Roshi : Edhe Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike në lidhje me pikën 18, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Përsa i përket pikës 18 të R.D, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve ? Nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 18 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni kush nuk ka votuar ende.

Eni ma konfirmon votimin të lutem ?

Eneida Marku (asistenca) : Deri tani kolegët kanë votuar pro pikës 18 dhe janë ende disa kolegë të cilët po votojnë.

Përfundoi votimi.

Ani Dyrmishi : Atëherë faleminderit. Me gjithë votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim, miratohet dhe pika 18 e rendit të ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 19 dhe të fundit të rendit të ditës**, i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit Kryetar ! Dhe për pikën 19 të rendit të ditës, Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Rroshi.

Eneida Marku (asistenca) : Ju lutem Alneida, mikrofonin.

Ani Dyrmishi : Zonja Rroshi....

Alneida Roshi : Në lidhje me pikën 19, Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Përsa i përket pikës 19 të R.D, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve ? Nuk kemi, kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 19 të R.D?(ndërkohë qetësi, po votohet në chat).

Kundra ?..... Apstenim?.....Ju lutem votoni të gjithë kush nuk ka votuar.

Eni mund të ma konfirmosh vazhdon procesi i votimit apo ka përfunduar ?

Eneida Marku (asistenca) : Ende nuk ka përfunduar.

Kolegët kanë votuar pro pikës 19, asnjë kundra, asnjë apstenim.

Ani Dyrmishi : Atëherë me gjithë votat pro, asnjë kundër, asnjë apstenim miratohet dhe pika 19 e rendit të ditës.

Nëse kryetarja ka diçka për të shtuar.

Emiriana Sako : Ju falenderoj. Desha të jap një sqarim për shkollat meqënëse u bë miratimi i vijimit të procedurave për shembjen e tyre. Objektet Eftali Koçi dhe Bernardina Qeraxhi janë gati për të filluar punën. Është zgjedhur dhe firma fituese dhe ishte vetëm ky ngërçi i dokumentacionit ligjor që duhej miratimi në Këshilli për të vijuar punën. Ndërsa objektet e gjimnazeve Naimi, Gjergji dhe Olsi Lasko janë në fazën e fundit të përfundimit të projekteve ekzekutive. Pastaj do të bëhet gara po nga UNDP-ia dhe do të filloj puna në terren. “Ne” që javën tjetër do të fillojmë, me zbardhjen e këtyre vendimeve, do të fillojmë procesin e shembjeve të objekteve në mënyrë që të kemi kantierin dhe sheshin gati për të filluar puna sa më parë. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare. Falenderoj dhe të gjithë këshilltarët e pranishëm në mbledhje. Për mbledhjet e ardhshme do të njoftoheni në rrugë elektronike nga Sekretaria e Këshillit . Ju falenderoj të gjithëve dhe mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Shihemi së shpejti.

Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 18 (tetëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funksionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :	ANI DYRMISHI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :	ELIO JANI
Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :	ETLEVA VELÇANI